

FJALA E DEPUTETES MILVA EKONOMI

E ENJTE 31 MARS 2022

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumë të nderuar qytetarë,

Very pleased to have you here from the UK Parliament, colleges! We are very delighted to discuss this session with you! Thank you!

Në fakt, nuk janë aspak kohëra të lehta. Të gjithë e kanë të vështirë të përballen me rritjen e çmimit të naftës, të gazit dhe të energjisë dhe, po t'i shtojmë kësaj edhe rritjen e çmimeve të produkteve bazë të shportës, të konsumit familjar të përditshëm, natyrisht që nuk është e lehtë. Por këtë situatë po e kalojnë të gjithë, jo vetëm Shqipëria. Kjo situatë ka mbërthyer të gjithë Europën, të gjithë botën dhe vjen si një rezultat kombinimi unikal të krizave, nga kriza energjetike, te kriza e zinxhirit të furnizimit për shkak të luftës në Ukrainë, në radhë të parë. Kjo i ka ngadalësuar marrëdhëniet tregtare në të gjithë kontinentin, ku ekonomitë e vendeve prej kohësh kanë një ndërveprim global të shtuar.

Sikurse njofton INSTAT-i, e rikonfirmon edhe Banka e Shqipërisë, inflacioni në muajin shkurt ishte 3,9% më i lartë se një vit më parë, grupi i shpenzimeve për ushqime u rrit me 6,9%, ndërsa grupi i shpenzimeve për transportin u rrit me 10,4%. Të nderuar kolegë, dua t'ju vë në dijeni se, në qoftë se i drejtohem teoriës ekonomike dhe flasim për stagflation, ky nuk është rasti për Shqipërinë. Ne nuk jemi një indeks që tregon rritjen e inflacionit në një strukturë, ku ekonomia nuk ka rritje, në një strukturë ku papunësia vjen në rritje. Në fakt, të dhënat tregojnë të kundërtën. Të dhënat e publikuara tregojnë që Shqipëria ia doli të ketë vitin e kaluar rritjen ekonomike prej 8,5%, e konfirmuar nga institucionet ndërkombëtare. Shkalla jonë e papunësisë sot tregon të jetë 11,4% dhe numri i të punësuarve në këtë periudhë do të shkojë sa ai para tërmetit, dhe këtë e tregojnë llogaritë e shtetit.

Banka Europiane dhe shumë banka të vendeve të tjera europiane janë duke i riparë edhe një herë shifrat e inflacionit dhe në të gjitha vendet pritet të ketë një rritje të inflacionit, pra rritje të çmimeve të shportës, të artikujve bazë të konsumit. Në Bankën e Shqipërisë projeksionet tregojnë se Shqipëria pret të ketë një inflacion prej 6% këtë vit. Në vendin tonë të gjitha parashikimet, që bëhen duke parë bursën ndërkombëtare, tregojnë se në 6-mujorin e parë nuk do të ketë rënie të konsiderueshme të çmimit të energjisë elektrike dhe çmimit të naftës apo të gazit. Kjo krizë shumëdimensionale, pavarësisht nga gatishmëria e qeverisë, kërkon edhe një kuptim më të drejtë nga gjithsecili prej nesh; kërkon një reagim qytetar të informuar dhe të përgjegjshëm ndaj të gjithëve, sipërmarrës dhe familjarë, që janë çdo ditë të angazhuar për të vënë në punë biznesin e tyre. Për të gjitha familjet shqiptare, të cilat në këtë moment po i administrojnë me kujdes burimet e tyre financiare, shkon një falënderim i veçantë. Nuk është e lehtë, por duhet të informohemi dhe të mbështetemi fort te njëritjetri.

Qeveria bëri me dije që prej vjeshtës së vitit 2021 çmimi i energjisë po rrite në bursë. Çmimi i energjisë për familjet dhe bizneset e vogla vazhdon të mbetet i parritur, pra është i njëjti. Qeveria shqiptare nuk e

rriti çmimin e energjisë për familjet dhe biznesin e vogël, përkundrazi ajo i subvencionon me 80% të vlerës së faturës të gjitha këto biznese. Të mos harrojmë që buxheti i miratuar në fillim të këtij viti parashikoi një fond për ta kompensuar çmimin e energjisë për familjet në nevojë, të cilat edhe sot vazhdojnë ta paguajnë energjinë me 7 lekë për kilovat/orë, sepse qeveria rimburson pjesën tjetër të çmimit. Sot ne kemi 2 borde të krijuara nga qeveria: Bordin Kombëtar të Administrimit të Karburantit dhe Bordin e Transparencës për monitorimin e produkteve kryesore të shportës së konsumit familjar.

Por, ne jemi shumë të ndërgjegjshëm, të vetëdijshëm që në krye të herës se këto dy borde nuk janë të natyrshme për sistemin e ekonomisë së tregut që kemi zgjedhur t'i përkasim, por në këto dy borde janë përfshirë përfaqësues të bizneseve, të prodhuesve, të eksportuesve dhe të importuesve të mëdhenj për të adresuar një nga problematikat më të mprehta, për të mos cenuar bazën e jetës së përditshme: energjinë dhe ushqimet kryesore të shportës. Paketa jonë e rezistencës sociale, që kërkon ndryshime në buxhet dhe në sistemin e taksave kombëtare, është pa dyshim një paketë e menduar shumë mirë, me të dhënat e fundit të buxhetit, e krahasuar me të ardhurat dhe me shpenzimet mbi bazën e informacioneve të librave të shtetit për të punësuarit dhe pagat e tyre, mbi bazën e eksperiencave të grumbulluar nga menaxhimi i dy krizave më parë, por, edhe duke bërë kujdes se çfarë bëjnë vendet e rajonit dhe ato europiane në këtë situatë.

Po t'u drejtohem të dhënave të Eurostatit, do të shikoni se Shqipëria nuk është vendi i fundit në rajon për nga varfëria. Ju lutem, hidhini edhe një herë sytë dhe do të shikoni se numri i të varfërve në Shqipëri është më i vogël se sa ai që kanë Mali i Zi dhe disa vende të tjera të rajonit! Çdo ditë qeveria u është gjendur pranë familjeve në nevojë dhe atyre që fitojnë më pak para. Prandaj me këtë filozofi vjen edhe prezantimi i kësaj pakete të rezistencës sociale. Ky akt normativ kërkon të lëvizë krahun e të ardhurave, të shpenzimeve që ta akomodojë këto nevoja që ka paketa e rezistencës sociale. Qeveria dje mori një vendim shumë të rëndësishëm, që ishte vendimi i rritjes së pensioneve me 3,3% për të gjitha kategoritë e pensioneve të plota apo jo të plota. Buxheti do të akomodojë 3,3 miliardë lekë për 673 mijë e 542 përfitues, pra për rreth gjysmë milioni shqiptarë, do të kompensohen për rritjen e çmimit të shportës me 3 mijë lekë në muaj. Edhe një herë, çmimet që përmban shporta për sa u përket produkteve ushqimore, janë rritur me 6,9%.

Kjo rritje tregon që qeveria mbulon pikërisht këtë masë të nevojave që kanë familjet shqiptare në konsumin e produkteve bazë. Edhe pse në tregun e punës janë aktivë njerëz që lëvizin nga rajonet, qeveria mori përsipër të kompensojë biletën e tyre; as një lekë shtesë nuk paguajnë ata që janë në tregun e punës, që punojnë si në zonën urbane, ashtu edhe në atë suburbane, sepse transporti qytetas dhe ndërqytetas do të financohet nëpërmjet kompanive të transportit për të mos rritur çmimin e biletës. Kjo shumë shkon në 500 milionë lekë, por, gjithashtu, të punësuarit në fshat qeveria vazhdon t'i mbështesë me skemën e naftës, e cila u aplikua vjet për herë të parë dhe tregoi se ishte një skemë shumë efikase, ku aplikuan rreth 19 mijë e 600 e ca fermerë. Sot aplikimet kanë shkuar shumë më shumë, duke përdorur të gjithë sasinë e parave të vëna në dispozicion. Meqenëse çmimi i naftës në bursat ndërkombëtare po rritet, qeveria e ka shtuar edhe këtë skemë të mbështetjes, duke e çuar në 1,45 miliardë lekë. Qeveria do të marrë masa edhe për sa u përket shpenzimeve të saj të administratës dhe, siç e keni dëgjuar, do të ulen shpenzimet në administratë për të gjitha automjetet që janë në dispozicion, të administratës qendrore apo vendore, me 50%.

Sot në Shqipëri janë aktive, sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, 117 mijë biznese. Të gjitha bizneset e vogla, që jetojnë dhe operojnë në Shqipëri, i kanë prej kohësh TVSHnë dhe tatim-fitimin zero. Ndërsa bizneset e mëdha që nga viti 2014 paguajnë tatim-fitimin prej 15%, sepse parimi ynë udhëheqës është: kush fiton më shumë, paguan më shumë. Me këtë parim që kemi filozofi, është bërë edhe qasja kundrejt kontributit në ekonominë e vendit edhe në paketën e rezistencës sociale. Po hyn dy muaj para në fuqi ligji për zerimin e taksës për pagat deri në 400 mijë lekë të vjetër, përgjysmimi i taksës për pagat deri në 500 mijë lekë të vjetër, si dhe ulja e taksës për pagat nga 1,5 deri në 2 milionë lekë të vjetër. Pra, 56% e atyre, që punojnë në Shqipëri dhe paguhen me pagë, paguajnë zero taksa. Pagën minimale, duke filluar nga nesër, qeveria do ta bëjë 320 mijë lekë të vjetër. Të gjitha pagat e klasave të mesme buxhetore, që vijnë nga sektori i arsimit, nga sektori i shëndetësisë apo edhe nga sektori i kulturës, janë parashikuar që të rriten në këtë projektbuxhet. Ky është një premtim i mbajtur, që do ta shikoni në datën 1 korrik, kur do të rriten pagat e këtyre kategorive.

Ndryshimet në të dyja kahet e buxhetit, pa dyshim që mbështeten në performancën e të ardhurave tatimore dhe doganore nga administrata fiskale, e cila në dymujorin e parë të këtij viti bëri një analizë të hollësishme dhe dolën të dhëna shumë të rëndësishme për të akomoduar shpenzimet që po bëhen në paketën e rezistencës sociale. Të ndërgjegjshëm se kjo periudhë shoqërohet edhe me pasigurinë e përgjithshme se sa do të zgjasë kjo situatë, kur do të mbarojë, qeveria u bën thirrje të gjitha kompanive që operojnë në zinxhirin e furnizimit me energji dhe me ushqime, të investojnë duke vendosur garancinë sovrane, të investojnë për të blerë produktet që ato shesin më shumë, t'i kenë rezervë këtu në vendin tonë, më pas t'i përdorin për njerëzit që kanë nevojë. Qeveria garanton nëpërmjet garancisë sovrane se do t'ua blejë atyre këto produkte.

Nuk janë kohëra të lehta, por ama këtu në Shqipëri njerëzit e zakonshëm vazhdojnë të punojnë çdo ditë me këmbëngulje dhe me rezultate të mira, sepse si kurdoherë ata e dinë që vetëm të bashkuar mund t'ia dalin. Po të shikojmë shifrat e eksportit të ISTATit për këtë dymujor, vëmë re se kemi arritur një shifër rritëse prej 50,5%, në krahasim me shkurtin e muajit të kaluar dhe kjo vjen si rezultat i atyre që punojnë në sektorin e minierave, të materialeve të ndërtimit, në tekstile dhe në prodhimin e këpucëve dhe të atyre që punojnë në sektorin e bujqësisë. Eksportet në bujqësi u rritën me 14% dhe vetëm puna e njerëzve të zakonshëm e sjell këtë rritje të vlerave të eksportit, prandaj do t'ju lutesha shumë që këtë akt normativ ta miratojmë si për buxhetin, ashtu edhe për taksat, duke iu ardhur në ndihmë të gjithë njerëzve që të bashkuar duan ta përballojnë këtë krizë të vështirë ekonomike që ka mbërthyer të gjithë globin! Faleminderit!